

**FEDERATA E BOKSIT
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: fboxk@hotmail.com
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I floor no3, 10000 Pristina, Kosova
NLB Bank No: 1701001010850503

Në bazë të nenit 26 nenpika 2 e statutit të FBOXK në mbledhjen e anëtarve
të kuvendit të mbajtur me 05.05.2022 miratoj :

RREGULLORJA

MBI PUNËN E BORDIT TË FEDERATËS SË BOKSIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 05.05.2022

**FEDERATA E BOKSIT
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: fboxk@hotmail.com
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I floor no3, 10000 Pristina, Kosova
NLB Bank No: 1701001010850503

I. DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1

Bordin e përbëjnë 10 anëtarët e zgjedhur në Kuvendin zgjedhor, si dhe 3 anetaret e zgjedhur nga Kryetari i Federates se boksit të bazuar në dispozitat statutare neni 28,në periudhë kohore prej 4 viteve.

Bordi numëron 13 anëtarë dhe përbëhet prej:Kryetarit,dy nënkryetarëve dhe dhjete antarëve tjerë,prej të cilëve shtate zgjedhen nga kuvendi,ndërsa tre emërohen nga Kryetari. Anëtarët e Bordit zgjedhen nga Kuvendi me mandate kater vjeqar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandatë.

Në Bordin e Federatës duhet të jenë të përfaqësuara edhe minoritet dhe femrat në përputhje me dispozitat e Ligjit për Sportin. Bordi është organ ekzekutiv i Kuvendit dhe numëron 13 anëtarë. Bordin e zgjedh Kuvendi.

Bordin e FboxK –së e përbëjnë : Kryetari, 2(dy)nënkryetarë dhe 10 anëtarë tjerë.

Kryetarin, dy(2) nënkryetarët dhe 5 anëtarë i zgjedh Kuvendi, ndërsa 3 anëtarë i zgjedh Kryetari.

Kryetarët e Shoqatave të gjyqtarëve dhe trajnerëve automatikisht janë edhe anëtarë të Bordit.

Në radhët e personave të propozura për Bordin e FboxK-së , duhet të jenë persona të gjinisë femrore dhe mës së paku 10% nga bashksitë e pakicave etnike që jetojnë në Kosovë.

Zgjedhja e anëtarëve të Bordit bëhet me vota të fshehta. Lista përfshinë emrat e kandidatëve dhe postet e tyre në Bord.

Kryetarët e Shoqatave të trajnerëve dhe gjyqtarëve automatikisht janë edhe anëtarë të Bordit të FboxK-së.

Kryetari i Bordit është edhe Kryetar i Kuvendit.

Neni 2

Puna e Bordit realizohet në mbledhjet punese, të cilat mund të thirren dhe mbahen sipas nevojës e së paku 4 herë në vit.

II. PËRGADITJA DHE THIRRJA E MLEDHJEVE TË BORDIT

Neni 3

Thirrja për mbledhjen e Bordit me propozimin e rendit të ditës dhe materialin për mbledhje, u dërgohet anëtarëve 7 dita para mbajtjes së mbledhjes.

Për çështje urgjente, mbledhja mund të mbahet edhe në ditën e thirrjes pa ftesë dhe rend dite.

Neni 4

Mbledhja e Bordit mund të mbahet në qoftëse në mbledhje marrin pjesë më shumë se $\frac{1}{2}$ e anëtarëve (7) anëtar të Bordit.

Në rastet e mungesës së numrit të duhur të anëtarëve të Bordit, mbledhja shtyhet dhe caktohet terimini tjetër i mbledhjes për deri sa nuk sigurohet shumica e anëtarëve.

Fq.3

III. UDHËHEQJA E PUNËS DHE VENDOSJA NË MBLEDHJE

Neni 5

Bordi udhëheq me punën e Federatës në mes të dy mbledhjeve të Kuvendit. Mbledhjet i thërret Kryetari e në mungesë të tijë njëri prej dy nënkryetarëve ose Sekretari i përgjithshëm.

Mbledhjet janë të rregullta ose të jashtëzakonshme, mbledhja e jashtëzakonshme mund të konvokohet nëse për një gjë të tillë deklarohet shumica e anëtarëve të Bordit.

Neni 6

Para fillimit të mbledhjes, Kryetari ose Sekretari gjeneral vërteton numrin e anëtarëve që janë prezent dhe të atyre që mungojnë dhe i njoftonë të pranishmit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve dhe se mund të mirren vendime fuqiplotë.

Neni 7

Në mbledhjen e parë të Bordit, bëhet konstituimi dhe zgjedhen organet e përhershme të Bordit.

Neni 8

Kryetari i Bordit, e hapë mbledhjen dhe i pyet të pranishmit se a pajtohen me rendin e ditës të propozuar dhe e hapë diskutimin. Në bazë të diskutimeve caktohet rendi i ditës dhe fillon mbledhja sipas pikave të rendit të ditës.

Neni 9

Anëtarët e Bordit marrin pjesë në diskutime për të gjitha pikat e rendit të ditës, kërkojnë shpjegime, shtrojnë pyetje dhe kërkojnë përgjigje nga referuesit.

Neni 10

Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës udhëheqet veç e veç, sipas rregullit së pari në parim e pastaj në veçanti.

Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon kryetari. Kryetari mund të propozojë që koha e shqyrtimit të kufizohet.

Neni 11

Askush nuk mund të marrë pjesë në diskutim para se t'ia japë fjalë Kryetari, të ndërhyjnë në fjalë pjesëmarrësit në diskutim, apo në ndonjë mënyrë tjetër të pengojë punën e mbledhjes.

Kryetari ka të drejtë që personit, i cili pengon punën normale të mbledhjes, ti japë vërejtje, t'ia marrë fjalën e në rast të prishjes së rendit të ditës t'a largojë nga mbledhja.

Neni 12

Diskutimi sipas pikave të veçanta të rendit të ditës zgjatë sipas rregullës deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë të paraqiturve.

Kryetari mbyllë diskutimin dhe propozonë që të kalohet në vendosje.

Në bazë të propozimeve në material, mendimeve të paraqitura gjatë diskutimeve, Kryetari formulon rezymetë, apo vendimet dhe të njejtat i paraqet në votim.

Neni 13

Mbi propozimet e vendimeve vendoset me votime të hapta, i cili bëhet me ngritjen e dorës, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numrim.

Vendimi konsiderohet i aprovuar, nëse për atë deklarohen më shumë se gjysma e anëtarëve prezent.

IV. ZGJEDHJA - KOOPTIMI I ANËTARËVE TË BORDIT

Neni 14

Nëse për çfarëdo arsye numri i anëtarëve të Bordit zvoglohet për 1/3, Bordi do të bëjë plotësimin me anëtarë të rinjë.

Anëtarët e zgjedhur – kooptuar 3 nga kryetari i kanë të drejtat dhe obligimet e njëta sikurse anëtarët e zgjedhur në Kuvendin zgjedhor të Federatës ë boksit..

Mandati i anëtarëve të rinjë zgjatë aq sa ka mbetur i pakryer mandati i anëtarit të Bordit.

V. KOMPETENCAT E BORDIT

Neni 15

Bordi kryen këto pune:

- Propozon Statutin dhe aktet tjera Kuvendit,
- Pregatit mbledhjet e Kuvendit dhe materialin përcjellës,
- Egzekuton vendimet e Kuvendit,
- Aprovon listen e zyrtareve të ndeshjeve dhe rregulloret e brendshme të Federatës,
- Përpilon planin e punes dhe atë financiar të Federatës,
- Vendos për blerjen ose shitjen e pasurisë së Federatës,
- Emëron dhe shkarkon Sekretarin e përgjithshëm,
- Aprovon planprogramin e punës së Këshillit profesional,
- Emëron dhe shkarkon trajnerët e reprezentacioneve,

- Aprovon raportet e Këshillave dhe Komisioneve të Bordit,
 - Miraton sitemin e garave,kalendarin dhe propozicionet e garave,
 - Bartë të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e Federatës,
 - Cakton lartësinë e anetarësisë dhe kotizimeve për anëtarët e Federatës,
 - Cakton lartësinë e taksës për zyrtarë të ndeshjeve, -Vendosë për pranimin e punetorëve dhe bashkepunetoreve në Federatë dhe për lartësinë e pagave të tyre,
 - Emëron dhe shkarkon Këshillat dhe Komisionet e Bordit,
 - Vendos edhe për çështjet tjera të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit.
- Bordi mund të formojë komisione të përhershme dhe ad hock,vendos për kompetenca të tyre dhe emëron anëtarët e tyre.Komisionet dhe këshillat për punën e tyre i përgjigjen Bordit.
- Komisionet-Këshillat e përhershme janë:
- Këshilli profesional,
 - Komisioni për kalimin dhe regjistrimin e boksierëve,
 - Komisioni-komisari i garave,
 - Komisioni Disiplinor dhe
 - Komisioni për shpërblime.

-VII-KRYETARI

Kryetarin dhe dy nënkryetarët i zgjedh Kuvendi me mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.Njëri nga nënkryetarët duhet të jetë nga radhët e pakicave.

Kryetari në fushveprimtarinë e vetë kryen këto punë:

Kompetencat e Kryetarit të Bordit janë:

- Kryetari i Bordit të FboxK-së përfaqëson Federatën, thëret seancën e Bordit, udhëheq me seancat e Bordit dhe të Kuvendit.
- Nënshkruan vendimet e Bordit e të Kuvendit,
- Kujdeset për zbatimin e plotë të programeve të punës dhe atyre financiare,
- Nënshkruan Vendimet dhe konkluzat e Bordit dhe të Kuvendit,
- Ka të drejt vetoje në Vendimet e Bordit dhe organeve tjera deri në seancën e parë të Kuvendit,
- Merrë Vendime në kushte të jashtzakonshme kur nuk mund të mbledhet Bordi apo
- Kuvendi dhe i njofton këto organe në momentin e parë të mundshëm,
- Ka të drejt të largojë nga Bordi çdo anëtar të tij, nëse nuk është aktiv apo nuk vepron në frymën e akteve normative të FboxK-së dhe synimeve të saj, deri në seancën e parë të Kuvendit,
- Kryetari për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të FboxK.
- Kryetari mund të shkarkohet edhe para skadimit të afatit zgjedhor me humbjen e besimit ose me krkesën e vet.
- Për shkarkimin e kryetarit, vendoset nëse me vota deklarohen mbi 2/3 e numrit të delegatëve të pranishëm në Kuvend.
- Propozon Sekretarin e FboxK-së dhe kryen edhe punë tjera sipas nevojës dhe kërkesave që kërkon momenti dhe Kuvendi apo Bordi.

-VIII-SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sekretarin e përgjithshëm e emëron Bordi me vendim pune pa afat te kufizuar

Sekretari i përgjithshëm në fushveprimtarinë e vetë i kryen këto punë:

- Udhëheq me punën e zyrës së Federatës,
- Egzekuton vendimet e Kuvendit,Bordit dhe të Komisioneve të Federates,
- Realizon bashkëpunimin me EABA dhe, IBA dhe me Federatat dhe organizatat tjera sportive jashte Kosovës,
- Realizon bashkëpunimin me KOK-un,Departamentin e Sporteve dhe organizatat tjera sportive në Kosovë,
- Pregatitë mbledhjet e Kuvendit,Bordit , të Këshillave dhe Komisioneve,
- Mer pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve, Këshillave dhe komisioneve të Federatës ne cilësinë e këshilldhënësit.

- Mban kontakte me mjetet e informimit,
- Propozon Bordit, profilin e bashkëpunorëve profesional-administrativë,
- Kryen edhe punë tjera të cilat dalin nga aktet tjera normative të FboxK-ës.

VI. ZGJEDHJA E ORGANEVE TE BORDIT

Neni 16

Në mbledhjen e parë të Bordit bëhet verifikimi i mandatit të anëtarëve në 4 vite dhe zgjedhet sipas nenit 31 te Statutit të FBOX-it:

- Këshilli profesional
 - Komisioni disiplinor
- Komisioni i garave.
- Komisioni për regjistrim
- Shoqata e trajnerëve,
- Shoqata e gjyqetarëve,
- Komisioni mbikqyres,
- Komisioni për shpërblime

Sipas nevojës, Bordi formonë edhe komisione dhe trupa tjerë punues, mandati i të cilëve zgjatë deri në kryerjen e detyrës për të cilën janë formuar.

VII. PROCESVERBALET

Neni 17

Mbi punën e Bordit, në mbledhje udhëheqet procesverbali. Procesverbalin, sipas rregullës e udhëheqë Sekretari, ose personi të cilin e cakton Kryetari në fillim të mbledhjes.

Neni 18

Procesverbali mbi punën e Bordit përmbanë të dhënat themelore, dhe atë: ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, shenjën dhe numrin e mbledhjes, numrin e anëtarëve prezent të Bordit dhe jo prezent, personat tjerë që prezentojnë, emrin e kryesuesit dhe emrin e procesmbajtësit, rendi i përcaktuar i ditës, emrat e paraqitësve dhe pjesëmarrsëve në diskutim me përmbajtje të shkurtër të diskutimit dhe rezultatet e votimit sipas pikave të veçanta të rendit të ditës, mendimet të ndara të anëtarëve të Bordit dhe të çështjeve tjera me rëndësi.

Në fund të çdo pike të rendit të ditës shenohet përfundimi sipas sipas rendit të formulimit, ashtu si e paraqet Kryetari.

Neni 19

Procesverbali përpunohet në origjinal dhe numër të mjaftuar te egzemplareve, Procesverbali origjinal nënshkruhet nga Kryetari dhe procesmbajtësi dhe i njejtë ruhet me materialin tjetër të mbledhjes në arkiv.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 20

Çështjet të cilat nuk janë rregulluar me këtë Rregullore, rregullohen me vendime të veçanta të Bordit.

Neni 21

Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e aprovimit dhe zbatohet nga dita në të cilën është aprovuar.

Neni 22

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullorje, pushonë të vlejë Rregullorja e mëparshme e Bordit.

Kryetari i FboxK-së
Enver Krasniqi



Prishtinë më 05.05.2022